



FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR
SCHOOL SPORTS FEDERATION

STATUTI I FSSHRK-së



Përmbajtja

1.	EMRI, FORMA DHE ADRESA	2
2.	QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA E FEDERATËS	4
3.	ANËTARËT E FEDERATËS	5
4.	ORGANET E FEDERATËS	5
5.	KUVENDI.....	6
6.	BORDI	8
7.	KRYETARI	Error! Bookmark not defined. 9
8.	SEKRETARI I PËRGJITHSHËM	11
9.	KËSHILLI MBIKQYRËS	11
10.	KËSHILLAT DHE KOMISIONET E BORDIT EKZEKUTIV.....	12
10.1.	KËSHILLI PROFESIONAL.....	12
10.2.	KOMISIONI PËR AKTE NORMATIVE	13
10.3.	KOMISIONI PËR	
ANKESA.....		12
10.4.	KOMISIONI DISIPLINOR	13
10.5.	KOMISIONI PËR INFORMIM DHE MARKETING	13
10.6.	KOMISIONI SHËNDETËSOR	14
10.7.	KOMISIONI PËR MIRËNJOHJE	14
11.	GARAT	15
12.	PASURIA, DHE MJETE MATERIALO- FINANCIARE	15
13.	SHËRBIMI ADMINISTRATIVO-PROFESIONAL	16
14.	RREGULLORET E BRENDSHME.....	16
15.	DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT.....	17



Në bazë të nenit 27 të Ligjit për sport të Kosovës, Udhëzimit administrative të akteve nënligjore të DS të MKRS-së dhe Ligjit 05/L-075 Parandalimit dhe Sanksionimit të Dhunës dhe Dukurive Negative në ngjarjet Sportive, Kuvendi i Federatës së Hendbollit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 12 Tetor 2022 plotësoi dhe aprovoi këtë:

STATUT TË FEDERATËS SË SPORTIT SHKOLLOR TË KOSOVËS

1. EMRI, FORMA DHE ADRESA

- 1.1. Federata e Sportit Shkollor e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme FEDERATA ose FSSH e Republikës së Kosovës), është asociacion vullnetar i pavarur, profesional, pedagogjik e sportiv e cila bashkon të gjithë arsimtarët – pedagogët e kulturës fizike dhe sportit shkollor, të anëtarësuar në të gjitha shoqatat e komunave përkatëse të ndara në shtatë (7) Regjionet e saj.
- 1.2. Si federatë bashkon nxënësit e organizuar dhe të regjistruar në klube dhe shoqatat sportive të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta, arsimtarët dhe trajnerët e tyre, gjyqtarët, veprimtarët, gazetarët, mjekët dhe administratorët sportivë, drejtuesit e sporteve përkatëse, individët dhe dashamirët e sportit shkollor.
- 1.3. Shoqatat apo organizatat e organizuara në komunat e Kosovës, veprimtaria elementare e të cilave është puna profesionale – pedagogjike e sportive në procesin mësimor të edukimit fizik dhe sportiv të nxënësve, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare e racore, gjinore, prejardhjen sociale, mendimin politik apo opinionin e tij, por që mbrojnë qëllimin, të drejtat, obligimet dhe programet mbi bashkimin e interesave të përcaktuara me këtë statut me qëllime e interesa të veçanta e të përbashkëta në lëmin e edukimit fizik dhe sportit në veçanti.
- 1.4. Federata e Sportit Shkollor e Republikës së Kosovës është organizatë profesionale-pedagogjike, joqeveritare, jopolitike dhe jofitimprurëse
 - 1.5. Emri i Federatës është: **FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**
 - 1.5.1. Shkurtesa është: FSSHRK
 - 1.5.2. Selia e Federatës është në Prishtinë. Adresa: Rr. “Agim Ramadani” –nr-43, Shtëpia e Sportit, 10000 – Prishtinë.
 - 1.5.3. Federata vepron në tërë territorin e Kosovës.
- 1.6. Federata është subjekt juridik. Ajo inicion, organizon, drejton dhe kontrollon zhvillimin e sportit në të gjitha nivelet e arsimit të ulët dhe të lartë në Kosovë.
 - 1.6.1. Punën e bazon në aktet e veta normative, Ligjin për sportin e Kosovës dhe Ligjin mbi organizatat jofitimprurëse.
 - 1.6.2. Federata përgjigjet për obligimet e krijuara me të gjitha mjetet e saja.
 - 1.6.3. Federata e ka xhirollogarinë e vet në Pro Kredit Bankë. (PCB)

- 1.7.** Federata, si organizatë jofitimprurëse është e regjistruar në organin përgjegjës të Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe e licencuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës (Departamentin e Sportit).
- 1.8.** Federata e ka logon, vulën dhe flamurin e vet.
- 1.8.1.** Logoja është e përbërë prej një pende e cila simbolizon edukimin e arsimimin, në mes të saj është atleti duke vrapuar, kurse sipër saj është flaka olimpike që simbolizon garën, sipër janë të vendosur gjashtë yje të cilët simbolizojnë komunitetet të cila jetojnë në Kosovë, dhe në krye të logos është shkurtesa e emërimit të federatës FSSHRK.
- 1.8.2.** Logoja e Federatës është e mbrojtur dhe mund të përdoret vetëm me lejen e Bordit të Federatës.
- 1.8.3.** Federata ka vulën katrore dhe të rrumbullakët të shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze.
- 1.9.** Federata është anëtare e Komitetit Olimpik të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: (KOK)).
- 1.9.1** Federata është anëtare e Federatës Botërore të Sportit Shkollor (në tekstin e mëtejshëm: (ISF-ja).
- 1.9.2** Federata punon në bazë të akteve të veta normative, të cilat janë të harmonizuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për sportin e Kosovës dhe Statutin e KOK-ut.
- 1.9.3** Federata mund të anëtarësohet edhe në asociacione tjera sportive vendore dhe ndërkombëtare.
- 1.9.4** Federata është organizatë jashtë partiake dhe veprimtaria e saj nuk ka për qëllim çfarëdo aktiviteti politik si dhe nuk mund të anëtarësohet në asnjë organizatë ose parti politike.
- 1.9.5** Federata nuk lejon çfarëdo mënyre të diskriminimit.
- 1.10.** Federatën e përfaqësojnë Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm, Financieri (arkëtari) ose personi i autorizuar nga Bordi i Federatës.
- 1.11.** Konstituimi i Federatës është i bazuar në parimet e shprehjes së vullnetit të lirë, interesave të përbashkëta, të drejtave të barabarta dhe në këtë bazë rregullohen marrëdhëniet reciproke, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësia e subjekteve konstituive të saj.
- 1.12.** Me konstituimin e Federatës, subjektet e saj pranojnë të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e parashikuara me këtë statut.
- 1.13.** Puna e Federatës është publike, dhe për punën e saj Federata opinionin e njofton nëpërmjet:
- Buletineve (Informatorëve), mjeteve të informimit, rrjeteve sociale si dhe nëpërmjet organizimit të konferencave për media.
- Anëtarët e vet i njofton nëpërmjet:
- Procesverbaleve të mbledhjeve të organeve dhe Këshillave dhe komisioneve,
 - Buletineve dhe publikimeve tjera, dhe
 - Mjeteve të informimit.

2. QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA E FEDERATËS

2.1. Qëllimet e federatës janë:

- Organizimi, masivizimi dhe zhvillimi cilësor i mësimit dhe aktiviteteve sportive në të gjitha nivelet e arsimit parafillor, të mesëm të ulët dhe të lartë në Kosovë.
- Sigurimi dhe realizimi i të gjitha kushteve për veprimtarinë e seleksioneve të arsimit parauniversitar, shkollave të mesme të ulët dhe lartë të Kosovës.
- Organizimi dhe avancimi profesional i pedagogëve, nxënësve, trajnerëve , gjyqtarëve, vëzhguesve dhe administratorëve të sporteve përkatëse në të gjitha nivelet shkollore të Kosovës.
- Ndihma organizatave të tjera në promovimin e sportit në përputhje me aktet normative.
- Përcaktimi i sistemit të garave për të gjitha kategoritë e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta.
- Mbështetja e zhvillimit të sportit shkollor në viset rurale të Republikës së Kosovës.
- Organizimi i të gjitha garave në nivel të Kosovës: Ligat, Kupa, si dhe të atyre gjatë manifestimeve të ndryshme për nderë të festave kombëtare e shtetërore të Republikës së Kosovës etj.
- Organizimi i aktiviteteve profesionale vendore dhe ndërkombëtare.
- Organizimi i seminareve, kampeve dhe publikimeve profesionale e shkencore, etj.
- Sigurimi i bazës materiale për zhvillimin e sportit nëpërmjet marketingut dhe aktiviteteve ekonomike me qëllim të përmbushjes së kërkesave për veprimtarinë e Federatës.
- Përcaktimi i parimeve themelore mbi definimin e statusit të të gjitha subjekteve në kuadër të Federatës.
- Pjesëmarrja e subjekteve përkatëse në aktivitetet e KOK-ut dhe të asociacioneve të tjera sportive.
- Veprime për Fair Play dhe kundër dopingut, në përputhje me Deklaratën e Lousannes, të 4 shkurtit 1999, vendimet e KOK-ut dhe “ISF” (Organizata Ndërkombëtare Botërore e Sportit Shkollor).
- Pjesëmarrja në aktivitetet e organizatave tjera sportive kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat janë të lidhura me sportit shkollor dhe rreth sportit.

3. ANËTARËT E FEDERATËS

- 3.1. Anëtar të FSSHRK-së mund të jenë shkollat, shoqatat e pedagogëve të kulturës fizike dhe sportit shkollor të gjitha komunave në territorin e Republikës së Kosovës.
- 3.2. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për anëtarësim në Federatë janë:
 - 3.2.1. Deklarata me shkrim e anëtarëve të shoqatës, shkollës për aplikim dhe respektimin e statutit dhe akteve tjera normative të saj.
 - 3.2.2. Numri i të anëtarësuarve në shoqatën, shkollën komunale të pedagogëve të kulturës fizike dhe sportit shkollor.
 - 3.2.3. Nënshkrimet e themeluesve dhe numrat e kartelave të tyre të identifikimit.
 - 3.2.4. Certifikata e regjistrimit të shoqatës, klubit.
 - 3.2.5. Statutin
 - 3.2.6. Rregullorja mbi punën e Kuvendit
 - 3.2.7. Rregullorja mbi punën e Bordit
 - 3.2.8. Rregullorja mbi punën e komisionit mbikëqyrës.
 - 3.2.9. Emrat e personave të autorizuar për përfaqësim.
 - 3.2.10. Numri i xhirollogarisë.
 - 3.2.11. Marrëveshja për zgjidhjen e kontesteve.
 - 3.2.12. Bordi i Federatës pranon anëtarët e ri, ndërsa kuvendi verifikon anëtarësimin e tyre në Federatë.
- 3.3. Anëtarët kanë të drejta dhe obligime ndaj saj.
- 3.4. Anëtari mund të përjashtohet nga Federata kur bën shkelje të rëndë të Statutit dhe akteve tjera normative të saj.
- 3.5. Vendimin mbi përjashtim nga anëtarësia e bie Kuvendi i Federatës. Efektet e përjashtimit veprojnë nga dita e marrjes së vendimit.

4. ORGANET E FEDERATËS

- 4.1. Organet e federatës janë:
 - Kuvendi
 - Bordi
 - Kryetari
 - Këshilli Mbikëqyrës
 - Këshilli Profesional

5. KUVENDI

- 5.1.** Kuvendi është organi më i lartë qeverisës i Federatës, i cili përbëhet prej delegatëve të autorizuar të Shoqatave komunale të Republikës së Kosovës.
- 5.1.1.** Shoqatat në Kuvend përfaqësohen me nga një delegatë.
- 5.2.** Në mbledhjen e kuvendit marrin pjesë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, por pa të drejtë vote.
- 5.3.** Në punën e kuvendit mund të marrin pjesë edhe mysafirët e ftuar – por pa të drejtë vote.
- 5.3.1.** Vetëm delegatët e autorizuar të shoqatave, kanë të drejtë të propozojnë, të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet udhëheqëse të Federatës.
- 5.3.2.** Numri i përgjithshëm i delegatëve të autorizuar është rregulluar në bazë të pikës 5.1.1. të këtij statuti.
- 5.3.3.** Mandati i delegatit në kuvend zgjatë katër (4) vjet.
- 5.3.4.** Delegati në kuvend dhe në organet e kuvendit për kryerjen e detyrës së delegatit i përgjigjet Shoqatës e cila e ka deleguar dhe organit në të cilin ai kryen detyrën e delegatit.
- 5.3.5.** Në qoftë se delegati nuk e kryen detyrën e tij me përgjegjësi, mund të revokohet edhe para skadimit të mandatit sipas procedimit të parashikuar.
- 5.3.6.** Propozimin mbi revokim mund ta bëjë shoqata e cila e ka deleguar ose organi i kuvendit ku ai kryen detyrën e delegatit.
- 5.3.7.** Delegati revokohet nga Federata dhe në vend të tij shoqata delegon delegatin tjetër.
- 5.4.** Mbledhjet e kuvendit mund të jenë të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
- 5.4.1.** Kuvendi i rregullt mbahet sipas nevojës, por më së paku një (1) herë në vjet, të cilin e thërret Bordi.
- 5.4.2.** Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta thërras Kryetari, Bordi, 2/3 e anëtarëve të Federatës ose me kërkesën e Këshillit Mbikëqyrës.
- 5.4.3.** Ftesa për kuvend duhet të dërgohet më së largu 14 ditë para mbledhjes, ndërsa materiali 7 ditë para kuvendit.
- 5.4.4.** Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të vendos vetëm për çështjet për të cilat është thirrur.
- 5.4.5.** Kuvendin e jashtëzakonshëm duhet ta thërras Kryetari në afat prej 30 ditëve, prej ditës së kërkesës, në të kundërtën kuvendin mund ta thërras edhe iniciuesi i procedurës.
- 5.4.6.** Kuvendi mund të bie vendime në qoftë se janë të pranishëm më shumë se gjysma e delegatëve të kuvendit.
- 5.5.** Kuvendi e zgjedh kryesinë e punës, procesmbajtësin, komisionin verifikues dhe në qoftë se ka nevojë edhe trupa tjera punuese (komisionin zgjedhorë, kur kemi Kuvend zgjedhorë).
- 5.5.1.** Në mbledhje mbahet procesverbali, të cilin e nënshkruajnë Kryetari, anëtarët e Kryesisë së Punës dhe procesmbajtësi.

- 5.5.2. Kuvendi merr vendime me votat e shumicës të delegatëve të autorizuar prezentë në kuvend, të cilët kanë të drejtë vote.
- 5.5.3. Në qoftë se vendoset për ndryshimin e statutit, atëherë nevojitet vota e 2/3 e numrit të delegatëve prezentë në kuvend.
- 5.5.4. Votimi në kuvend është publik, në qoftë se kuvendi nuk vendos ndryshe.
- 5.5.5. Kuvendin e udhëheq Kryesia e punës, të cilën e përbëjnë: Kryetari i Federatës dhe dy (2) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi.
- 5.5.6. Vendimet e kuvendit janë të obligueshme për të gjithë anëtarët dhe organet e Federatës.
- 5.5.7. Procedimi dhe mënyra e punës së kuvendit rregullohen me rregulloren e punës së tij.
- 5.6. Shpenzimet e pjesëmarrjes në mbledhje të Kuvendit i bartë vet anëtari i Kuvendit.
- 5.7. **Kuvendi në fushë veprimtarinë e vet i kryen këto punë:**
- Plotëson Ndryshon dhe miraton Statutin e FSSHRK-së,
 - Miraton Rregulloren e punës së Kuvendit
 - Miraton Rregulloren e Këshillit Mbikëqyrës
 - Miraton rregulloret e garave të federatës
 - Miraton sistemin e garave për të gjitha ekipet e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta të Kosovës
 - Miraton Rregulloren disiplinore të Federatës
 - Miraton raportet e punës së organeve të veta
 - Zhvillon politikën e federatës
 - Miraton programet afatshkurtër dhe afatmesme, programin vjetor, Planin financiar dhe llogarinë përfundimtare vjetore
 - Verifikon mandatin e delegatëve të autorizuar në kuvend
 - Pranon anëtarë të ri dhe përjashton anëtarët nga anëtarësia e Federatës
 - Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe anëtarët e Bordit
 - Zgjedh dhe shkarkon Këshillin Mbikëqyrës
 - Vendos në lidhje me mjetet e jashtëzakonshme juridike
 - Vendos mbi faljen e dënimeve
 - Shqyrton programet dhe raportet e shoqatave, klubeve
 - Interpretton Statutin e Federatës
 - Kryen edhe punë të tjera në përputhje me Statutin dhe aktet tjera normative të Federatës
 - Kuvendi, me vendim të veçantë mund t'ia bartë Bordit ndonjë nga kompetencat e veta
 - Vendos mbi pushimin e punës së Federatës

6. BORDI

- 6.1. Bordi i FSSHRK-së (në tekstin e mëtutjeshëm “Bordi”) është organ ekzekutiv i Kuvendit dhe udhëheq me punën e Federatës në mes të dy mbledhjeve të Kuvendit.
- 6.1.1. Mbledhjet i thërret Kryetari e në mungesë të tij nën/kryetari.
- 6.1.2. Mbledhjet janë të rregullta ose të jashtëzakonshme, mbledhja e jashtëzakonshme mund të thirret nëse për një gjë të tillë deklarohet shumica e anëtarëve të Bordit të FSSHRK-së.
- 6.1.3. Bordi numëron 11 anëtarë dhe përbëhet nga: Kryetari, një (1) nënkryetari dhe nëntë (9) anëtarëve.
- 6.2. Bordin e zgjedh kuvendi nga radha e delegatëve të autorizuar të kuvendit dhe atë: Kryetarin, një (1) nënkryetar dhe shtatë (7) anëtarë të tjerë, ndërsa Kryetari i zgjedh dy (2) anëtarë nga radha e delegatëve të autorizuar të kuvendit, në mungesë të kuotës gjinore kryetari shfrytëzon të drejtën të zgjedhë dy mësimdhënës/e nga shoqatat në teren.
- 6.2.1. Shtatë (7) Përfaqësuesit e Regjioneve të zgjedhur nga Shoqatat, me votim në kuvend automatikisht bëhen anëtarë të Bordit.
- 6.2.2. Në Bordin e FSSHRK-së duhet të jenë të përfaqësuara edhe minoritetet dhe gjinia femërore në përputhje me dispozitat e Ligjit për Sportin.
- 6.2.3. Kryetari i Federatës është Kryetar i Kuvendit dhe Bordit.
- 6.2.4. Bordi zgjidhet me mandat katër (4) vjeçar, sa është edhe mandati i Kuvendit, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për dy (2) mandate.
- 6.2.5. Bordi për punën e vet i përgjigjet kuvendit.
- 6.3. Anëtari i Bordit ose i tërë Bordi mund të shkarkohen nga Kuvendi edhe para skadimit të mandatit, në qoftë se vërtetohet se ka punuar në kundërshtim me Statutin dhe aktet e tjera normative të Federatës.
- 6.3.1. Në rastet kur shkarkohet Bordi në tërësi, Kuvendi mund të zgjedh një trup punues (Këshill ose Komision) nga radha e delegatëve të autorizuar të Kuvendit i cili do t'i kryejë punët e Bordit deri në mbledhjen e Kuvendit Zgjedhor.
- 6.3.2. Ky afat mund të jetë më së shumti deri 30 ditë nga dita e zgjedhjes së këtij trupi punues.
- 6.3.3. Mbi numrin e anëtarëve të trupit punues vendos Kuvendi.
- 6.4. Mënyra e punës dhe procedura e vendimmarrjes në Bordin e FSSHRK-ës, më përparësisht rregullohen me Rregulloren mbi punën e Bordit dhe Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.
- 6.5. **Bordi në fushë veprimtarinë e punës së vetë kryen këto punë:**
- Vendos për thirrjen dhe propozimin e rendit të ditës për mbledhjen e kuvendit.
 - Harton dhe propozon ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe akteve tjera normative dhe i propozon kuvendit.
 - Bie rregulloren mbi licencimin e shoqatave, klubeve
 - Ekzekuton vendimet dhe konkluzionet e kuvendit.
 - Bie rregulloren mbi punën e Bordit.
 - Përpilon planin e punës dhe planin financiar vjetor të Federatës.

- Ekzekuton politikën e përgjithshme të Federatës.
 - Emëron dhe shkarkon sekretarin e përgjithshëm.
 - Emëron dhe shkarkon anëtarët e trupave punues të Bordit.
 - Bie rregulloret e brendshme të cilat nuk janë në kompetencë të kuvendit.
 - Shqyrton dhe aprovon plan-programin e Këshillit Profesional.
 - Bart të drejtën e organizimit të garave nën ombrellën e Federatës.
 - Cakton lartësinë e taksës për personat zyrtarë të ndeshjeve.
 - Bie rregulloren mbi sistematizimin e vendeve të punës.
 - Vendos për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve për kryerjen e punëve të përhershme dhe të përkohshme dhe lartësinë e pagave të tyre.
 - Vendos edhe për çështjet tjera për të cilat e autorizon Kuvendi ose nuk janë të parashikuara me këtë statut.
 - Vendos mbi blerjen dhe shitjen e pasurisë së Federatës.
- 6.6.** Bordi mund të formojë komisione të përhershme dhe të përkohshme, vendos për kompetenca të tyre dhe emëron anëtarët e tyre.
- 6.7.** Mënyra e punës dhe procedimi i vendimmarrjes në trupat punuese, rregullohen me rregulloren mbi punën e Bordit.
- 6.8.** Mandati i anëtarëve të trupave punuese zgjatë katër (4) vjet me mundësi të rizgjedhjes edhe për një (1) mandat.
- 6.9.** Bordi mund të shkarkojë trupat punues ose anëtarin e tij edhe para skadimit të mandatit në qoftë se vërtetohet se detyrat e besuara nuk i kanë kryer me përgjegjësi dhe në kundërshtim me aktet normative të Federatës.
- 6.10.** Komisionet dhe këshillat për punën e tyre i përgjigjen Bordit.
- Komisionet-Këshillat e përhershme janë:
- Këshilli mbikëqyrës
 - Këshilli profesional
 - Komisioni për Akte Normative,
 - Komisioni Disiplinor,
 - Komisioni i ankesave
 - Komisioni për informim dhe marketing,
 - Komisioni shëndetësor, dhe
 - Komisioni për mirënjohje.

7. KRYETARI

- 7.1.** Kryetarin e zgjedh Kuvendi me mandat katër (4) vjeçar.
- 7.2.** Zgjedhja e kryetarit për herë të parë në Bordin e FSSHRK-së bëhet me anë të nominimit me shkrim nga klubi apo shoqata gjegjëse të anëtarësuar në FSSHRK.
- 7.3.** Kryetari i Bordit të FSSHRK-së mund të zgjidhet në të njëjtën funksion maksimum për tre mandate, dhe në kohën e zgjedhjes apo rizgjedhjes, nuk duhet ta ketë arritur moshën prej 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vite.



- 7.4.** Bordi i FSSHRK-së me rastin e rizgjedhjes së kryetarit, mund të ri nominon, pavarësisht a është nominuar nga shoqatat gjegjëse të FSSHRK-së.
- 7.5.** Kandidatin për Kryetar mund ta propozojnë delegatët e pranishëm në Kuvend, por paraprakisht kandidati duhet ta ketë përkrahjen e së paku 10 shoqatave në teren (delegatëve), ti dokumentoj dhe ti deponoj 10 nënshkrimet para anëtarëve të Kuvendit.
- 7.6.** Secila shoqatë ka të drejtën e nominimit vetëm të një kandidati.
- 7.7.** Kandidati për kryetar nuk mund të nominohet nëse ka ndonjë dënim për veprë penale të formës së prerë
- 7.8.** Kryetar zgjidhet ai kandidat i cili në rrethin e parë të votimit merr më së paku 2/3 e votave të delegatëve të pranishëm në Kuvend.
- 7.9.** Në qoftë se asnjëri nga kandidatët e propozuar për Kryetar nuk e merr këtë numër të votave, atëherë në rrethin e dytë të votimit delegatët e Kuvendit votojnë për dy (2) kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë marrë numrin më të madh të votave.
- 7.10.** Pas votimit në rrethin e dytë, për Kryetar zgjidhet kandidati i cili ka fituar numrin më të madh të votave.
- 7.11.** Nëse vjen deri te ndërprerja e parakohshme e mandatit të Presidentit për shkak të dorëheqjes, shkeljes së ligjit (dënimi i formës së prerë për veprë finale), vdekjes apo me mbajtjen e ndonjë Kuvendi të jashtëzakonshëm zgjedhorë mandati i presidentit nuk është me katërvjeçar por zgjatë deri në fund të ciklit Olimpik.
- 7.12. Kryetari në fushë veprimtarinë e vetë kryen këto punë:**
- Kompetencat e Kryetarit të Bordit janë:
- Përfaqëson Federatën në vend dhe jashtë saj
 - Thërret dhe udhëheq me punën e Bordit
 - Thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kuvendit
 - Kujdeset për realizimin e programeve, planeve dhe konkluzioneve të Kuvendit dhe Bordit
 - Kujdeset dhe është përgjegjës për punën e ligjshmërisë në Federatë
 - Është urdhërdhënës dhe përgjegjës për realizimin e planit financiar
 - Nënshkruan vendimet dhe aktet të cilat i bie Kuvendi dhe Bordi
 - Kujdeset për përgatitjen e materialeve për mbledhjet e Kuvendit dhe Bordit
 - Zbaton dhe udhëheq politikën e Federatës
 - Kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga ky Statut dhe vendimet e Kuvendit.
 - Kryetari për punën e tij i përgjigjet Kuvendit.
 - Kuvendi mund ta shkarkojë Kryetarin edhe para skadimit të mandatit, në qoftë se vërtetohet se ka punuar në kundërshtim me Statutin dhe aktet e tjera normative të Federatës.
 - Pas shkarkimit të Kryetarit, Kuvendi zgjedh Kryetarin e ri sipas procedurës së parashikuar në pikat 7.8, 7.9, 7.10 të këtij Statuti.

8. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

- 8.1.** Sekretarin e përgjithshëm e emëron Bordi me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes. Kriteret dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për emërimin e sekretarit të përgjithshëm parashikohen me rregulloren mbi punën e Bordit.
- 8.2. Sekretari i përgjithshëm në fushë veprimtarinë e vetë i kryen këto punë:**
- Përfaqëson Federatën, sipas autorizimeve të Bordit
 - Është urdhërdhënës për realizimin e planit financiar
 - Udhëheq dhe është përgjegjës për punën e zyrës së Federatës
 - Kujdeset dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës në Federatë
 - Kujdeset për ekzekutimin e vendimeve dhe konkluzioneve të Bordit dhe trupave punuese të tij
 - Së bashku me Kryetarin përgatit materialet për mbledhjen e Kuvendit dhe Bordit
 - Kryen punët me të cilat e ngarkon Bordi.
 - I propozon Bordit formimin e trupave punuese.
 - Realizon bashkëpunimin me Federatën ndërkombëtare të sportit shkollor (ISF) dhe organizatat tjera sportive në Kosovë dhe jashtë saj.
 - Realizon bashkëpunimin me KOK-un, Ministrinë e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, Departamentin e Sportit të Ministrisë Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës dhe organizatat tjera sportive në Kosovës dhe jashtë saj.
 - Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve dhe trupave punuese të Bordit në cilësinë e këshillëdhënësit.
 - Mbanë kontakte me mjetet e informimit.
 - Harton Rregulloren e sistematizimit të vendeve të punës në Federatë
 - I propozon Bordit profilin e bashkëpunëtorëve administrativo-profesional.
 - Interpretin aktet e brendshme normative të Federatës
 - Kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga aktet normative të Federatës si p.sh. çështjen e pagesave dhe njëherë ka rolin edhe të financierit-arkëtarit si dhe është personi i vetëm që ka qasje në xhirollogarinë e Federatës.
- 8.3.** Sekretari i përgjithshëm me Federatën themelon marrëdhënie të punës me pagesë me gjysmë norme me kontratë në afatin e caktuar të mandatit katër (4) vjeçar, në bazë të Ligjit mbi marrëdhëniet e punës.
- 8.3.1.** Sekretari i përgjithshëm mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit të tij, në qoftë se nuk i kryen obligimet me përgjegjësi të cilat dalin nga aktet normative të Federatës ose shkeljes dhe sjelljes së rëndë të dispozitave të ligjit mbi marrëdhënien të punës.
- 8.3.2.** Sekretarin e përgjithshëm, në rast të mungesës së tij, e zëvendëson personi të cilin e cakton Bordi.

9. KËSHILLI MBIKQYRËS

- 9.1.** Këshilli mbikëqyrës përbëhet prej tre (3) anëtarëve.
- 9.1.1.** Këshillin mbikëqyrës e zgjedhë Kuvendi me mandat katër (4) vjeçar.
- 9.1.2.** Anëtari i komisionit mbikëqyrës nuk mund të jetë nga radhët e delegatëve të autorizuar të kuvendit.



- 9.2. Bordi dhe të gjitha trupat e tij janë të obliguara që Këshillit mbikëqyrës ti ja mundësojnë mbikëqyrjen në punën e tyre.
- 9.3. Këshilli mbikëqyrës përcjellë punën e organeve të Kuvendit në mes të dy Kuvendeve dhe mbikëqyrë afarizmin financiar të Federatës.
- 9.4. Këshilli mbikëqyrës i raporton për punën e vetë Kuvendit të FSSHRK-ës.
- 9.5. Mënyra e punës së Këshillit mbikëqyrës më përafërsisht përcaktohet me Rregulloren mbi punën e Këshillit mbikëqyrës.

10. KËSHILLAT DHE KOMISIONET E BORDIT EKZEKUTIV

10.1. KËSHILLI PROFESIONAL

- 10.1.2. Këshilli profesional është trup punues i Bordit të Federatës.
- 10.1.3. Veprimtaria themelore e Këshillit Profesional, si trup punues i Bordit, është avancimi i punës profesionale e pedagogjike, veçanërisht me seleksionet përkatëse të sportit shkollor.
- 10.1.4. Këshilli profesional inicion dhe nxit aktivitetet për zgjidhjen e çështjeve të cilat janë në dobi të zhvillimit dhe ngritjes së cilësisë së sportit shkollor të nxënësve të shkollave fillore e atyre të mesme në Kosovë.
- 10.1.5. Këshilli profesional numëron 3-5 anëtarë, të cilët i emëron Bordi.
- 10.1.6. Anëtarët e Këshillit Profesional mund të jenë profesorët e kulturës fizike dhe sportit, trajnerët, gjyqtarët, gazetarët, mjekët, administratorët sportivë dhe dashamirët e sportit etj.
- 10.1.7. Mandati i Këshillit Profesional zgjatë katër (4) vjet, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një (1) mandat.
- 10.1.8. Këshilli profesional për punën e vet i përgjigjet Bordit.
- 10.1.9. **Të drejtat dhe obligimet e Këshillit profesional janë:**
 - Përcjellë zhvillimin e sportit brenda në shkolla të gjitha komunave të Kosovës.
 - Përcjell dhe mbikëqyrë realizimin e plan-programeve profesionale të aprovuara nga Bordi.
 - Kujdeset për zhvillimin profesional dhe popullarizimin e sportit shkollor në Kosovë.
 - Bashkëpunon me organizatat profesionale dhe shkencore me qëllim të avancimit të punës profesionale.
 - Harton dhe i propozon Bordit aprovimin e plan-programeve për zhvillimin e sportit shkollor me nxënësit e shkollave të mesme të ulëta dhe të larta në tërë territorin e Kosovës.
 - Kryen edhe punë të tjera me të cilat e ngarkon Bordi.
 - Anëtari dhe Këshilli profesional mund të shkarkohen edhe para skadimit të mandatit në qoftë se vërtetohet se nuk i kryen detyrat me përgjegjësi dhe në kundërshtim me aktet normative të Federatës.
- 10.1.10 Emërimi i anëtarit(ve) të ri bëhet sipas procedimit të parashikuar me pikën 6.6
- 10.1.11 Bordi i Federatës, në rastet e jashtëzakonshme mund të ndërmer masa me qëllim të zgjedhjes së çështjeve të cilat pamundësojnë punën e tyre normale dhe të suksesshme.

10.2. KOMISIONI PËR AKTE NORMATIVE

- 10.2.1** Komisioni për akte normative përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët i emëron Bordi i FSSHRK-së me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë.
- 10.2.2.** Komisioni për akte normative i FSSHRK-së ka për detyrë ti përgatisë të gjitha aktet normative në kuadër të Federatës, (Rregulloret e ndryshme të Bordit të FSSHRK-së, shoqatave apo komisioneve , të cilat duhet të jenë në përputhshmëri me aktet normative të ISF, dhe AOK-ut, dhe të Ligjit për Sport dhe akteve nënligjore të DSK-së.
- 10.2.3.** Të gjitha vendimet e Komisionit për akte normative të FSSHRK-së merren me shumicën e votave.
- 10.2.4.** Vendimet e Komisionit për Akte normative të FSSHRK-së janë të plotfuqishme në qoftë se në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

10.3 KOMISIONI PËR ANKESA

- 10.3.1** Komisioni për ankesa përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët i emëron Bordi i FSSHRK-së me mandat katër vjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër.
- 10.3.2** Komisioni për ankesa ka për detyrë ti shqyrtoj ankesat e pjesëmarrësve në garat shkollore të cilët pretendojnë se ju ka bërë ndonjë padrejtësi.
- 10.3.3** Të gjitha vendimet e Komisionit për ankesa të FSSHRK-së merren me shumicën e votave.
- 10.3.4** Vendimet e Komisionit për Ankesa janë të plotfuqishme nëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

10.4 KOMISIONI DISIPLINOR

- 10.4.1** Komisioni disiplinor përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët i emëron Bordi i FSSHRK-së me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë.
- 10.4.1** Komisioni disiplinorë vendosë në shkallë të parë në lidhje me shkeljet e Rregullores disiplinore, me të cilën më përparësisht rregullohen të drejtat dhe obligimet e Komisionit, si dhe procedura e vendimmarrjes në lidhje me shkeljet disiplinore.
- 10.4.2** Të gjitha vendimet e Komisionit disiplinor të FSSHRK-së merren me shumicën e votave.
- 10.4.3** Vendimet e Këshillit disiplinor janë të plotfuqishme nëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

10.5 KOMISIONI PËR INFORMIM DHE MARKETING

- 10.5.1** Komisioni për informim dhe marketing përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët i emëron Bordi i FSSHRK-së me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë.
- 10.5.2** Komisioni për informim dhe marketing i FSSHRK-së ka për detyrë dhe qëllim, që me punën e vetë, të ngritë vlerat e FSSHRK-së, si dhe të informohet opinioni për punën e FSSHRK-së, me anë të botimit të broshurave të ndryshme, revistës së FSSHRK-së, rrjeteve sociale dhe njëkohësisht të kryej punë rreth marketingut të FSSHRK-së me



të cilin do të siguroheshin mjetet materiale për aktivitetet e FSSHRK-së, qoftë në planin e brendshëm apo atë ndërkombëtarë.

10.5.3 Për ndihmë në realizimin e afarizmit të Federatës, mundë të punësohet zyrtari për marketing në përputhje me Ligjin mbi marrëdhënien e punës.

10.5.4 Të gjitha vendimet në Komisionin për informim dhe marketing merren me shumicën e votave. Vendimet e Komisionit janë të plotfuqishme nëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

10.6 KOMISIONI SHËNDETËSOR

10.6.1 Komisioni shëndetësorë përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët i emëron Bordi i FSSHRK-së me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë.

10.6.2 Komisioni shëndetësorë ka për detyrë të kujdeset për të arriturat e medicinës sportive në zhvillimin dhe përparimin e sportit shkollor si dhe për mbrojtjen shëndetësore të nxënësve dhe personave tjerë të inkuadruar në këtë aktivitet sporti.

10.6.3 Në Komision duhet të ketë mjek të gjitha profileve mjekësore.

10.7 KOMISIONI PËR MIRËNJOHJE

10.7.1 Komisioni për mirënjohje prej tre anëtarëve, të cilët i emëron Bordi i FSSHRK-së me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë.

10.7.2 Komisioni për mirënjohje dhe shpërblime, ka për detyrë që ti propozon Bordit të FSSHRK-së, sportistët apo institucionet për mirënjohje apo shpërblime, duke pasur parasysh angazhimin, punën, sukseset si dhe prezantimin e sportit Kosovar në vend dhe jashtë vendit.

10.7.3 Federata e Sportit Shkollor parasheh këto mirënjohje dhe dekorata, për sportistët ekipet, Shoqatat, punëtorët sportive, gazetarët sportiv dhe individ tjerë si vijon:

- Mirënjohje
- Falënderime
- Diploma për ekipe
- Diploma për individ
- Plaketa (e artë, agentë dhe e bronzit)
- Medalje (e artë, agentë dhe e bronzit)
- Shenja të FSSHRK-së (e artë, e argjend dhe e bronzit)
- Flamuj përkujtimor
- Kupa
- Dhurata dhe rekuizita sportive
- Dhuratë speciale për masivitet, cilësi dhe fair - play
- Dhuratë speciale, përcjellja e ndonjë manifestimi apo ngjarje me rëndësi sportive në Kosovë apo jashtë sajë
- Dhuratë me të holla të gatshme

10.7.4 Të gjitha vendimet në Komisionin për mirënjohje dhe shpërblime merren me shumicën e votave. Vendimet e Këshillave dhe Komisioneve janë të plotfuqishme nëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

11. GARAT

- 11.1. Garat zyrtare të sportit shkollor mund të organizohen vetëm nga Federata të autorizuar nga Bordi i Federatës së Sportit Shkollor të Kosovës.
- 11.2. Garat zhvillohen në bazë të rregullave zyrtare të Federatave të Kosovës dhe Federatës Ndërkombëtare (ISF) të Sporteve përkatëse.
- 11.3. Në udhëheqjen e garave, organi përkatës i garave duhet t'i respektoj të gjitha vendimet e organeve të sporteve përkatëse.
- 11.4. Kalendarin dhe propozicionet e garave e përgatitë Komisioni Teknik i Këshillit profesional për çdo sport veç e veç, të cilin e aprovon Bordi i Federatës së Sportit Shkollor.
- 11.5. Kalendarin e garave për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta dhe të larta, përgatitet çdo herë një vit më para, d.m.th. në fillim të çdo viti shkollor.
- 11.6. Kalendarin e ri i garave përgatitet për vitin e ardhshëm shkollor.
- 11.7. Garat zhvillohen në bazë të rregullave zyrtare të Federatave të Kosovës dhe Federatës Ndërkombëtare (ISF) të Sporteve përkatëse, dhe duhet ti respektoj të gjitha vendimet në bazë të Ligjit për parandalimin e dhunës në sport dhe aktet tjera nënligjore apo udhëzimet tjera që dalin nga MKRS-ja.
- 11.8. Fillimin, shtyrjen, Propozicionet e garave i miraton Bordi
- 11.9. Federata e Sportit Shkollor e Kosovës është e obliguar të kujdeset për punën e reprezentacioneve dhe të siguroj mjete financiare që t'u krijoj kushte sa më të mira për punë.
- 11.10. Paraqitja për Representacionin përkatës të shkollave të Kosovës, është obligim dhe nderë për çdo nxënës të ekipit në sportin përkatës në të cilin bën gara.

12. PASURIA, DHE MJETET MATERIALO- FINANCIARE

- 12.1. Federata financohet nga:
 - Donacionet e personave fizikë dhe juridikë
 - Marketingu
 - Të hyrat nga organizimi i garave
 - Donacionet nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë
 - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës
 - Departamentit të Arsimit, Kulturës dhe Rinisë dhe Drejtorisë për sport të kuvendeve komunale dhe rajonale për aktivitetet e caktuara
 - Burimet e tjera të lejuara në bazë të Ligjit; Burimet nga TV transmetimet etj.
- 12.2. Me afarizmin financiar të Federatës përgjegjës është Kryetari i FSSHRK-së, në bazë të planit financiar dhe vendimeve të Kuvendit dhe Bordit të FSSHRK-së.
- 12.3. Për ndihmë në realizimin e afarizmit të Federatës, mundë të punësohet zyrtari financiar në përputhje me Ligjin mbi marrëdhënien e punës.
- 12.4. Federata mund të fitojë ne posedim pasuri të tundshme dhe të patundshme, Bordi vendos për fitimin e pasurisë së patundshme, për shitjen e saj, për bartjen e saj në personin tjetër juridik ose për dhënien me qira të pasurisë së patundshme.

13. SHËRBIMI ADMINISTRATIVO-PROFESIONAL

- 13.1.** Federata mundë të themeloj marrëdhënie të punës me punëtorët të cilët do të punojnë në shërbimin profesional dhe administrativ të Federatës. Për punësimin e zyrtarëve dhe për lartësinë e pagave vendos Bordi i FSSHRK-së me propozim të Sekretarit të përgjithshëm.
- 13.2.** Federatat mund të punësoi zyrtarë për kryerjen e punëve në administratë për zhvillimin e garave në rrafshin e brendshëm për punë teknike.
- 13.3.** Federata mund të punësoi zyrtarë për kryerjen e punëve në administratë, zyrtari i cili do të mbajë kontakte me ISF, si dhe federatat tjera ndërkombëtare, për zhvillimin e garave dhe aktiviteteve në rrafshin ndërkombëtarë.
- 13.4.** Me shërbimin administrativ të FSSHRK-së udhëheq sekretari i përgjithshëm i FSSHRK-së dhe i përgjigjet Bordit të FSSHRK-së.

14. RREGULLORET E BRENDSHME

- 14.1.** Rregulloret e brendshme dhe kalendari i garave nuk guxojnë të pësojnë ndryshime, gjatë edicionit garues i cili është në rrjedhën e sipër.
- 14.2.** Në procedurat administrative të cilat zhvillohen pranë organeve kompetente të Federatës mund të përdoren mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.
- 14.3.** Për çështjet administrative të cilat nuk janë rregulluara me këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e Kodit mbi procedurat administrative. (Deri në miratimin e Kodit të sipërpërmendur do të aplikohen dispozitat e Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative).
- 14.4.** Mbi të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e individit dhe organizatave në FSSHRK vendos Bordi i FSSHRK-së, përveç në raste kur me këtë Statut dhe Akte tjera Normative të përgjithshme kjo e drejtë është bartur në kompetenca të Komisioneve ose trupave të tjerë të Bordit.
- 14.5.** Vendimet e Bordit të FSSHRK-së të marra në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni janë përfundimtare dhe kundër tyre nuk lejohet ankesa.
- 14.6.** Kundër vendimit të Komisioneve dhe trupave të Bordit të FSSHRK-së, mund të paraqitet ankesa Bordit të FSSHRK-së në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.
 - 14.6.1.** Bordi i FSSHRK-së është e obliguar të vendos sipas ankesës në afat prej 30 ditëve, nga dita e paraqitjes së ankesës dhe vendimin e vet palëve të interesuara ua dorëzon në afat prej 8 ditëve.
 - 14.6.2.** Në qoftë se në aktin përfundimtar të organit apo trupit tjetër të Bordit të FSSHRK-së cenohen dispozitat e marrëveshjes, dispozitat e Statutit dhe Akteve tjera Normative të Federatës individi i interesuar, organi ose organizata mund të iniciojë fillimin e procedurës për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e Ligjshmërisë. Propozimi i tillë në formë të shkruar, i dorëzohet kryetarit të Kuvendit përmes Komisionit të Akteve Normative të Bordit të FSSHRK-së në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së formës së prerë të aktit të kontestuar.
 - 14.6.3.** Komisioni i Akteve i Bordit është i obliguar në afat prej 15 ditëve nga dita e paraqitjes së propozimit duhet ta përgatisë arsyetimin me shkrim rreth afatit të paraqitjes dhe bazushmërisë së propozimit e të cilin ia dorëzon kryetarit të Kuvendit. Kryetari i

- Kuvendit është i obliguar në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së mendimit të Komisionit të Akteve të merr vendim nga propozimi.
- 14.6.4. Në qoftë se kryetari i Kuvendit konteston se propozimi për paraqitjen e ankesës për mbrojtjen e Ligjshmërisë është paraqitur pas afatit të paraparë merr vendim për hedhjen e propozimit si të paraqitur pas kalimit të afatit të paraparë. Vendimi i nxjerrë në përputhje me paragrafin paraprak është përfundimtar dhe kundër tij nuk lejohet ankesa. Në qoftë se kryetari i Kuvendit konteston se propozimi është paraqitur në afatin e paraparë, të njëjtin ia dorëzon Bordit të FSSHRK-së në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së vendimit të vet.
- 14.6.5. Me rastin e marrjes së vendimit mbi propozimin e paraqitur të kërkesës për mbrojtjen e Ligjshmërisë, Bordi i FSSHRK –së mund të vendos që kërkesën ta aprovojë dhe aktin kontestues t'ia kthej organit kompetent në rishqyrtim dhe rivendosje, përkatësisht kërkesën ta aprovojë dhe aktin kontestues ta ndryshojë në aspektin e thënieve ankimore ose të njëjtin ta refuzojë si të pa bazë.
- 14.6.6. Bordi i FSSHRK-së është i obliguar që vendimin mbi paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e Ligjshmërisë ta bien në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.
- 14.7.** Federata pushon së vepruari kur Kuvendi me 2/3 e votave dhe nënshkruesit e marrëveshjes kontestojnë se nuk ekzistojnë kushtet materiale dhe shoqërore për veprimtarinë e mëtejme dhe sipas forcës së Ligjit.
- 14.7.1. Në rast të pushimit të veprimit të FSSHRK-së, e gjithë pasuria, të drejta dhe obligimet kalojnë në shfrytëzim dhe dispozicion të organizatave tjera për përparimin e këtij sporti.

15. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

- 15.1.** Ky Statut hynë në fuqi ditën e aprovimit të plotësimeve nga Kuvendi i Federatës. Më hyrjen në fuqi të këtij Statuti pushon të vlejë Statuti i miratuar me 28.10.2016.
- 15.2.** Nëse ky Statut në ndonjë pike has në kundërtënie me Ligjin për sport, Ligjin për parandalimin e dhunës në sport dhe aktet tjera nënligjore apo udhëzimet të cilat dalin nga MKRS atëherë vlejnë dispozitat e akteve normative që dalin nga Ligji për sport, Ligji për parandalimin e dhunës në Sport dhe udhëzimeve tjera administrative.
- 15.3.** Aktet e përgjithshme të FSSHRK-së, Statutet e Shoqatave dhe aktet tjera duhet të harmonizohen në afat prej 90 ditë prej ditës se hyrjes në fuqi të këtij statuti.
- 15.4.** Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit bëhen sipas procedurës së paraparë kur janë miratuar. Interpretimin e këtij Statuti e bënë Kuvendi i Federatës.

Adrian TELAKU d.v.

Kryetar i FSSHRK-së